

Nr. Regj.62578/12

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA KUNDËR KORUPCIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	N. Prot.
Dep. DPK/DMP	Prot. no. 03-1786/13
Nr. Hap.	Data
Broj. Matrica	02
Nr. Pasap.	10.06.2013

GJYKATA THEMELORE- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqtaren Vjollca Limani, në procedurën kundërvajtëse të zhvilluar kundër të pandehurit Illija Vlladimir Mlladenovic nga Prishtina, për veprën kundërvajtëse të paraparë në nenin 3 në pajtim me nenin 5 dhe 6 paragrafi 1 pika 1 të sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit nr. 04/L-050, e në mbështetje të neneve 7, 73, 74, 195 dhe 198 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtje, me datë 14.05.2013, merr këtë :

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Illija Vlladimir Mlladenovic nga Prishtinë me vendbanim në Graçanicë, për veprën kundërvajtëse të paraparë në nenin 3 në pajtim me nenin 5 dhe 6 paragrafi 1 pika 1 të sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, nr.04/L-050, konform nenit 198 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtje, nga se nuk ka prova se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen që i ngarkohet.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, me kërkesën nr.01-4281/12 të dt.26.11.2012, ka kërkuar që të zhvillohet procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit për veprën kundërvajtëse si më lartë përshkak se i pandehuri nuk e ka bërë deklarin e pasurisë me rastin e marrjes e detyrës.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjykata inicioi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit, i cili në mbrojtjen e tij deklaroi: në muajin Qershor e kam pranuar detyrën e Drejtorit dhe pas kësaj Aleksandra Gjekic-Udhëheqëse Personeli e ka njoftuar agjensionin për ndryshimet që ka pësuar lista e KK Graçanicë, dhe tani kur ka filluar faza e deklarimit të rregullt e kam pyetur lidhur me këtë çështje dhe ajo më ka thënë se e kam njoftuar me kohë Agjensionin dhe se nuk ka kurrfarë përgjegjje e as formular lidhur me deklarimin tim. Po ashtu Aleksandra më ka njoftuar se drejtori i këtij agjencioni ka thënë se pas njoftimit që kanë bërë, zyrtaret kanë qenë të obliguar të dërgojnë formularin për deklarim. Shton se nuk e ka ditur për këtë obligim ligjor ngase përndryshe do të përmbushja atë. I propozon gjykatës që lidhur me këtë çështje të dëgjohet Aleksandra Gjekic.

Gjykata sipas propozimit në cilësinë e dëshmitares, dëgjoi Aleksandra Gjekic-Udhëheqëse e Personelit në Kuvendin Komunal të Graçanicës, e cila deklaroi: është e vërtetë se Ilia Mlladenovic detyrën e Drejtorit e ka pranuar në muajin Qershor, mirëpo unë si pikë kontakti kam menduar se zyrtarët publik kanë për obligim vetëm deklarimin e rregullt sic edhe parashihet me ligj deri me datë 31 Mars të çdo viti, kjo ka qenë pikërisht arsyeja që unë nuk e kam njoftuar Illija Mlladenovic. Në muajin shtator kam pranuar email nga Agjensionin të cilët kanë kërkuar që të paraqes ndryshimet e listës, nëse ndryshime të tilla ka, kështu që unë menjëherë i kam njoftuar për ndryshimet mirëpo përkundër këtij informacioni ata nuk na kanë njoftuar për këtë obligim të deklarimit me rastin e pranimit të detyrës. Shton se i vije keq që mos deklarimi i pasurisë së të pandehurit ka ndodhur si pasojë e mos informimit nga ana ime, e kjo mungesë e informacionit tim është pasojë e mos sigurimit të informacionit nga ana e Agjensionit Kundër Korrupsionit.

Lidhur me këtë çështje është dëgjuar edhe përfaqësuesi i Agjensionit Kundër Korrupsion- Enis Sadiku, i cili deklaroi: si në këtë rast ashtu edhe në rastet tjera Agjencioni nga pikat kontaktuese ka kërkuar me dt.25.09.2012 të paraqesin ndryshimet në listat e zyrtarëve, nëse ndryshime të tilla ka, kështu që po në këtë datë jemi njoftuar po ashtu përmes emailit nga pika kontaktuese e Kuvendit Komunal Graçanicë-Aleksandra Gjekic, për ndryshimet e listës ku edhe është përfshirë emri i të pandehurit Ilia Mlladenovic. Përkundër kësaj i njëjti nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë.

Kështu që pas dëgjimit të deklaratës së pandehurit, dëgjimit të pikës kontaktuese, parashtruesit të kërkesës, shqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjykata konfom nenit 198 pika 8, vendosi si më lartë duke e pezulluar procedurës kundërvajtëse, në mungesë të provave të cilat tregojnë se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen që i ngarkohet.

Aktvendimi i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit për Divizionin e Kundërvajtjes.

Gjyqtarja
Vjollca Limari

